



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.236/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Pejë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kështu që Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2014, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se më datë 07.06.2014, edhe pse heshtje zgjedhore, kandidati i PDK-së Shaip Muja ka bërë fushat duke shpërndarë sms me përmbajtje “Vendos për misionin e ri, voto sot PDK 58, 1 Hashim Thaçi dhe 89 Shaip Muja”. Sms-të janë dërguar tek Teuta Sahatçiu në ora 09:15 dhe Ramadan Lahu në ora 09:13.

LDK pretendon se me këtë veprim PDK ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet dërgimi i mesazhit nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës propozon që ndaj subjektit politik të lartë përmendur të ndërmerren masa ligjore në pajtim me LZP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it informoi subjektin politik PDK, më datë 07.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 08.06.2014, deri në ora 13:00.

PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit – përcaktohen bazuar në Nenin 36.1 të LZP-së dhe Nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndaloheq secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të: c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetë mijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padyshim subjekti politik PDK, ka thyer heshtjen zgjedhore, në mënyrën siç pretendohet në ankesë. Një gjë e tillë shihet nga fotografia e telefonit dhe sms nga telefoni i ankuesit, nga i cili rezulton se kandidati i PDK Shaip Muja ka dërguar gjatë heshtjes zgjedhore sms me këtë përmbajtje: “Vendos për misionin e ri, voto sot PDK 58, 1 Hashim Thaçi dhe 89 Shaip Muja”. Sms-të janë dërguar tek Teuta Sahatçiu në ora 09:15 dhe Ramadan Lahu në ora 09:13 të datës 07.06.2014.

Bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c), të LZP-së, përcaktohet çart se në rast se ka ndodhur shkelja e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, PZAP-i mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në lartësi deri në 50000 euro. Sipas Rregullës Nr.01/2012 për “*Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave*”, neni 6 par.2 specifikon se “*në çoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre subjekti politik që është i përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet më gjobë nga 6500 euro deri në 25000 euro*”.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, në këto zgjedhje për herë të parë ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura, të njëjti subjekt i shqipton gjobën lart cekur si në diapozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 236/2014 më datën 08.06.2014



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzet (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesë mijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*